

Autore: Vladimir Ilievski
Ilustrimet: Aleksandar Sotirovski



DITA E BARDHIT

Originali u botua nga:

International Step By Step Association

Keizersgracht 62-64

1015 CS Amsterdam

The Netherlands

www.issa.nl

This book is a publication of the Reading Corner project

Text copyright © 2004 Vladimir Ilievski

Illustrations copyright © 2004 Aleksandar Sotirovski

Botues për Maqedoninë:

Fondacioni për iniciativa arsimore dhe kulturore

“Hap pas hapi” - Maqedoni

Përkthim nga anglisht në shqip:

Fondacioni për iniciativa arsimore dhe kulturore

“Hap pas hapi” - Maqedoni

Lektor:

Xhabir Ahmeti


Autore: Vladimir Ilievski
Ilustrimet: Aleksandar Sotirovski



DITA E BARDHIT


ORA SHSTATË E MËNGJESIT

Nëpër dritare dielli rrezet
i lëshoi, duhet të çohem –
Bardhi menjëherë e kuptoi.
I shtriu krahët lehtë dhe u
ngrit shpejt, ditën e re do
ta shijojë krejt.




ORA TETË E MËNGJESIT

Me pastë dhe brushë dhëmbët
i pastroi, me sapun veshë e
fytyrë fërkoi. Higjiena është
gjysma e shëndetit, ai mirë e
di, se mami i tregoi.




ORA NËNTË PARADITE

Kafjallin e shtroi nëna për bukuri, bukë, qumësht e sallameri. Shpejt të tëra i fshiu, ende bukë kërkon, se mëngjesi s'e ngiu. I tillë është ky djalë, e vjetër është kjo përrallë.



ORA DHJETË PARADITE

Bardhi me shokët në
blerinë do të shkojë, bën
plane të mëdha për lojë.
Moti është i bukur, çdo
lule lulëzon, topi kërcen si
flutur, lart xhita fluturon.



ORA NJËMBËDHJETË PARADITE

I uritur Bardhi ngutet në shtëpi, e pret lëngu e ndonjë ëmbëlsi. Për lojëra të reja ai mendon, zamra e shijshme për atë “ndihmon”.



ORA TRE PASDITE

Babi i lodhur nga puna
kthehet, djalë e puth, e
përshëndet. “A do të ma
tregosh babi një përrallë?
S’e refuzon dot babi se e
ka djalë për mallë.”



ORA KATËR PASDITE

I lodhur nga loja në blerinë e sokak,
pas dreke Bardhi bie pak. Ka nevojë,
një grimë pushon. Një libër me
ilustrime e shfleton, qesh ëmbël,
shoqërinë me libër e adhuron.




ORA GJASHTË PASDITE

Bie zilja, kush është vallë?
Gjyshja është - s'ka fjalë.
Pa durim, Bardhi do ta
shohë dhuratën e mirë në
duart e gjyshes së dëlirë.




ORA SHSTATË NË MBRËMJE

Në dhomë gjithandej gazi derdhet, para televizorit Bardhi është ulur e dëfrehet. Një film të vizatuar e ndjek i përqendruar, nga vendi fare nuk luan, Miki Mausin e ka personazh të preferuar.



ORA TETË NË MBRËMJE

Terri ngadalë qiellin e pushton, kur
në shtrat Bardhi shtatin e rehaton.
Pa mbretërinë e ëndrrave s'mundet
dot, udhëton në të i udhëhequr nga
Hënëza me yje plot.





USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

**MEMBER
OF ISSA**



ФОНДАЦИЈА ЗА ОБРАЗОВНИ И КУЛТУРНИ ИНИЦИЈАТИВИ
FOUNDATION FOR EDUCATION AND CULTURAL INITIATIVES
ЧЕКОР ПО ЧЕКОР • STEP BY STEP



www.stepbystep.org.mk